

## Rabati për Prodhimet Ndërkombëtare në Kosovë

Rabati për Prodhimet Ndërkombëtare në Kosovë zbatohet për projekte që realizohen tërësisht ose pjesërisht në Kosovë dhe që nxisin investime të huaja në sektorin e filmit dhe prodhimeve audio-vizuale.

**Sektori:** Kinematografia - Audiovizual - Inovacioni dhe shërbimet teknike

**Forma e mbështetjes financiare:** Rabat 30%

---

### Kush e ofron rabatin?

Rabati ofrohet nga **Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK)** dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, duke u bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet një kompanie vendore të prodhimit dhe investitorit të huaj. Shuma e rabatit transferohet në llogarinë bankare të kompanisë vendore në Kosovë, e cila duhet të jetë dedikuar vetëm për projektin audio-vizual.

---

### Afati i Aplikimit:

- I hapur gjatë gjithë vitit
- 

### Sa është shuma e rabatit?

- Rabati për prodhimet audio-vizuale është **30%** e shpenzimeve të pranueshme të kryera në Kosovë.
  - Prodhimet që marrin edhe fonde publike nga Republika e Kosovës mund të përfitojnë rabatin për shpenzimet që janë realizuar tërësisht në vend, por totali i përfitimeve (fonde publike + rabat) nuk mund të kalojë **50%** të buxhetit të përgjithshëm të prodhimit.
- 

### Cilat janë shpenzimet e pranueshme?

Rabati mbulon **30%** të shpenzimeve të mëposhtme, të realizuara në Kosovë (pa përfshirë TVSH-në):

- **Pagat dhe kontributet sociale** për skenaristët, aktorët dhe stafin teknik vendor.
- **Shërbime teknike** të ofruara nga kompani të specializuara në Kosovë.
- **Shpenzime udhëtimi, transporti dhe ushqimi** gjatë prodhimit.
- **Shpenzime për pajisje** të përdorura në territorin e Kosovës.

---

## Kush ka të drejtë për rabat?

- **Aplikanti** duhet të jetë një entitet biznesor i regjistruar në Kosovë për prodhime audio-vizuale, ose një filial i një kompanie të huaj.
- **Investitori i huaj** duhet të lidhë kontratë me një kompani vendore për realizimin e projektit.
- Kompania vendore duhet të jetë e regjistruar në **QKK**
- Aplikanti duhet të ketë të shfaqur publikisht të paktën një (1) projekt audio-vizual në tre (3) vitet e fundit.
- Aplikanti duhet të sigurojë **të paktën 50% të buxhetit** për prodhimin dhe **100% të investimit të huaj** në Kosovë.

---

## Cilat janë projektet e pranueshme?

Rabati mund të jepet për projekte që përmbushin kushtet e mëposhtme:

- Të jenë **filma artistikë, dokumentarë, animacione, seriale televizive, video-lojëra** ose prodhime të tjera audio-vizuale të ngjashme.
- Nuk pranohen projekte si ngjarje sportive, programe “reality show” apo emisione me përmbajtje politike dhe sociale të aktualitetit.
- Kërkesat minimale për shpenzime lokale janë:

Lloji i Projektit	Shpenzimi Minimal në Kosovë (€)
Filma Artistikë	175,000.00
Dokumentarë	75,000.00
Filma të Animuar	100,000.00
Episod i Serialit Televiziv	100,000.00
Video-lojëra (format i gjatë)	100,000.00
Projekte të Gjatesisë Mesatare	60,000.00 – 75,000.00
Projekte të Formatit të Shkurtër (reklama, videoklipe, etj.)	20,000.00 – 50,000.00

---

## Kur mund të mblidhet rabati?

Pagesat për rabatin realizohen në këste, pas përfundimit të prodhimit dhe dorëzimit të raportit përfundimtar financiar. Për projektet e gjata, rabati mund të ndahet në deri **3 këste**, ndërsa për projektet e shkurtra ose të mesme, zakonisht jepet në një këst të vetëm.

Pagesat e rabatit bëhen prej datës 1 Mars dhe 23 Dhjetor të çdo viti fiskal.

---

## Kur fillon periudha e shpenzimeve të pranueshme?

Shpenzimet e pranueshme mund të përfshijnë shpenzimet e realizuara deri në **6 muaj para** datës së dorëzimit të aplikacionit për rabat në QKK.

---

## INFORMACION PËR TVSH-në

- Kosova zbaton një **normë të përgjithshme të TVSH-së prej 18%** për mallrat dhe shërbimet.
  - **TVSH-ja nuk konsiderohet** si shpenzim i kualifikuar për rimbursim.
- 

## INFORMACION

Nëse keni nevojë për ndihmë për të kuptuar rregulloret ose përgatitjen e aplikimit, ju lutemi kontaktoni **Qendrën Kinematografike të Kosovës (QKK)**.

### Udhëzime për Prodhuesit Ndërkombëtarë

Qendra Kinematografike e Kosovës rekomandon që prodhuesit ndërkombëtarë, të cilët planifikojnë të realizojnë një film ose projekt televiziv në Kosovë, të bashkëpunojnë me një kompani të prodhimit të regjistruar në Kosovë. Producentët vendorë kanë marrëdhënie të mira me ekipet lokale dhe ofruesit e shërbimeve, duke ofruar një gamë të plotë shërbimesh prodhimi, përfshirë aplikimin për rabat, menaxhimin e buxhetit, kërkimin e lokacioneve, planifikimin, përzgjedhjen e aktorëve dhe rekrutimin e stafit. Profesionistët dhe shërbimet e nevojshme për prodhimin tuaj mund t'i gjeni në platformën **Kosova.film**

---

## **Kosovo Production Rebate for International Productions**

The Kosovo Production Rebate applies to projects that are fully or partially produced in Kosovo and aim to encourage foreign investment in the film and audiovisual sector.

**Sector:** Cinema - Audiovisual - Innovation and Technical Services

**Support Type:** Financial Reimbursement (Rebate) - 30%

---

### **Who Provides the Rebate?**

The rebate is offered by the Kosovo Cinematography Center (QKK) and the Ministry of Culture, Youth, and Sports, based on an agreement between a local production company and a foreign investor. The rebate amount is transferred to the bank account of the local production company in Kosovo, which must be dedicated exclusively to the audiovisual project.

---

### **Application Deadline:**

Open year-round

---

### **What is the Rebate Amount?**

The rebate for audiovisual productions is 30% of eligible expenses incurred in Kosovo. Projects that also receive public funding from the Republic of Kosovo can benefit from the rebate for expenses incurred entirely in the country. However, the total benefits (public funds + rebate) cannot exceed 50% of the total production budget.

---

### **What Are Eligible Expenses?**

The rebate covers 30% of the following expenses incurred in Kosovo (excluding VAT):

- Salaries and social contributions for local screenwriters, actors, and technical staff.
  - Technical services provided by specialized companies in Kosovo.
  - Travel, transportation, and catering expenses during production.
  - Equipment rental used within Kosovo territory.
- 

### **Who is Eligible for the Rebate?**

- The applicant must be a business entity registered in Kosovo for audiovisual production or a branch of a foreign company.
- The foreign investor must sign a contract with a local company for the execution of the project.
- The local company must be registered with QKK.
- The applicant must have publicly released at least one (1) audiovisual project in the last three (3) years.
- The applicant must secure at least 50% of the production budget and 100% of the foreign investment in Kosovo.

## What Projects Qualify?

The rebate can be granted for projects that meet the following conditions:

- Feature films, documentaries, animations, TV series, video games, or other similar audiovisual productions.
- Projects such as sporting events, reality shows, or programs with current political and social content are not accepted.
- Minimal local spending requirements are:

Project Type	Minimum Spending in Kosovo (€)
Feature Films	175,000.00
Documentaries	75,000.00
Animated Films	100,000.00
TV Series Episode	100,000.00
Video Games	100,000.00
Medium-Length Projects	60,000.00 – 75,000.00
Short-Format Projects (ads, music videos, etc.)	20,000.00 – 50,000.00

## When is the Rebate Paid?

Rebate payments are made in installments after production is completed and the final financial report is submitted.

- For long-format projects, the rebate can be divided into up to three (3) installments.

- For short or medium-length projects, it is usually paid in a single installment.
  - Rebate payments are made between March 1st and December 23rd of each fiscal year.
- 

## **When Do Eligible Expenses Begin?**

Eligible expenses may include costs incurred up to six (6) months before the rebate application is submitted to QKK.

---

## **VAT Information**

Kosovo applies a general VAT rate of 18% on goods and services. VAT is not considered a qualified expense for reimbursement.

---

## **Information & Guidance**

If you need assistance in understanding the regulations or preparing your application, please contact the Kosovo Cinematography Center (QKK).

---

## **Guidelines for International Producers**

The Kosovo Cinematography Center recommends that international producers planning to produce a film or television project in Kosovo collaborate with a registered local production company. Local producers have strong relationships with local crews and service providers, offering a full range of production services, including rebate applications, budget management, location scouting, scheduling, casting, and staff recruitment.

You can find the necessary professionals and services for your production at **Kosova.film**

---